



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1258 Dt 30.06.2021

Në bazë të nenit 47 dhe të nenit 49, pika 1.9. të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Senati i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2021, miratoi:

VENDIM

1. Aprovohet draft-Rregullorja mbi punën e Senatit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.
2. Pjesë e këtij vendimi është Rregullorja mbi punën e Senatit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Zyrës për Informim me Publikun.

Prof. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË**

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1258 Dt 30.06.2021

Në bazë të nenit 47 dhe të nenit 49, pika 1.9. të Statutit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, Senati i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2021, miratoi:

**Rregulloren
mbi Punën e Senatit**

**Fushëveprimtaria
Neni 1**

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Senatit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (thirrja e mbledhjes, kryesimi, mbajtja, mënyra e vendosjes, procedura e zgjedhjes, dhe zbatimi i vendimeve dhe çështje të tjera përkatëse).

**Thirrja e mbledhjes konstituive
Neni 2**

- (1) Mbledhjen konstituive të Senatit e thërret rektori aktual i Universitetit, i cili e kryeson atë vetëm derisa të zgjidhet kryesuesi i përkohshëm i Senatit.

**Verifikimi i mandateve
Neni 3**

- (1) Në mbledhjen e parë, Senati i verifikon mandatet e anëtarëve të Senatit në bazë të raportit të sekretarit të përgjithshëm, në lidhje me rregullsinë e zgjedhjeve të anëtarëve në Senat nga njësitë akademike, me propozim për verifikimin e mandatit.
- (2) Votimi për raportin bëhet në tërësi, nëse nuk është kontestuar asnjë mandat. Në rast se ndonjë mandat është kontestuar, së pari votohet për të gjitha mandatet e pakontestueshme, e pastaj për çdo mandat të kontestueshëm votohet veç e veç.
- (3) Nëse Senati konstaton se zgjedhja është bërë në mënyrë jo të rregullt, Senati do të kërkojë nga njësitë akademike që zgjedhjet e kontestuara të përsëriten.
- (4) Anëtari i Senatit, të cilit i është kontestuar ose i është shtyrë vendimi për verifikimin e mandatit, ka të drejtë të vazhdojë pjesëmarrjen në mbledhje, por pa të drejtë vote.

**Nënshkrimi i deklaratës etike
Neni 4**

Pas verifikimit të mandatit, anëtarët e Senatit e nënshkruajnë deklaratën etike si vijon: “*Deklaroj se do t’i kryej detyrat me nder dhe me besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, me ndërgjegje dhe përgjegjësi, se do t’i përfaqësoj me ndërgjegje dhe përkushtim interesat e Universitetit dhe se do t’i përmbahem Statutit të Universitetit*”.



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

**Zgjedhja e Kryesuesit të Përkohshëm
Neni 5**

- (1) Kryesuesi i përkohshëm i Senatit zgjedhet nga kandidatët e propozuar në Senat me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
- (2) Nëse asnjë nga kandidatët e propozuar nuk e merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, atëherë organizohet radha e dytë e votimit vetëm për kandidatin me numër më të madh të votave. Nëse kandidati nuk e merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve në radhën e dytë, konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe Senati është i obliguar të propozoj kandidat tjetër.
- (3) Në rast të votave të barabarta, votimi përsëritet.

**Mbledhjet dhe kryesimi
Neni 6**

- (1) Mbledhjet e Senatit i thërret dhe i kryeson rektori i Universitetit (në tekstin e mëtejme: kryesuesi) sipas detyrës zyrtare.
- (2) Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e përgatit dhe e kryeson njëri prej prorektorëve sipas radhës së përcaktuar paraprakisht nga rektori. Nëse edhe prorektorët nuk kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhje, mbledhjen e Senatit e kryeson anëtari më i vjetër i Senatit.
- (3) Kryesuesi mbledhjet e rregullta i thërret sipas nevojës. Gjatë periudhës së rregullt të studimeve, mbledhjet e Senatit mbahen së paku një herë në muaj.
- (4) Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen në çfarëdo kohe sipas procedurave të parapara. Rendi i ditës për këtë mbledhje duhet të jetë i kufizuar në një pikë kryesore dhe duhet të ju dërgohet anëtarëve të Senatit së paku një ditë para mbledhjes. Në mbledhjen e Senatit mund të vendoset për thirrjen e ndonjë mbledhje të ardhshme të rregullt apo të jashtëzakonshme të Senatit. Në këto raste, anëtarët e Senatit që nuk janë të pranishëm, duhet të ftohen posaçërisht.
- (5) Në rast të shkarkimit të rektorit dhe prorektorëve, procedurën e zgjedhjes e organizon anëtari më i vjetër i Senatit, pa asnjë vonesë.
- (6) Mbledhjet e Senatit janë të hapura për publikun, përpos në rastet kur Senati vendos ndryshe.
- (7) Anëtarët e Senatit ftohen së paku tri ditë para mbledhjes së rregullt. Ftesat mund të bëhen me shkrim, me fax, e-mail, ose në çfarëdo forme tjetër teknike, me të cilën dërgesa dhe informimi janë të sigurt.
- (8) Kryesuesi ka të drejtë në çfarëdo kohe të ftojë ekspertë ose persona të tjerë në mbledhje.
- (9) Kryesuesi është i obliguar të thërrasë mbledhjen e Senatit nëse këtë e kërkojnë së paku 1/3 e anëtarëve të Senatit dhe nëse qëllimi është i arsyetuar me shkrim. Nëse kryesuesi i Senatit nuk i përgjigjet kërkesës brenda tri ditësh nga dita e marrjes së kërkesës, mbledhjen e Senatit e thërret anëtari më i vjetër i Senatit.
- (10) Senati mund të organizojë mbledhje solemne me rastin e jubileve, festave dhe rasteve tjera të rëndësishme, si dhe mbledhje komemorative me rastin e vdekjes së një anëtari të dalluar të universitetit. Vendimin për organizimin e mbledhjeve të tilla e merr Rektori.

**Pjesëmarrja dhe votimi në mbledhje
Neni 7**

- (1) Të gjithë anëtarët e Senatit kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Senatit.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

- (2) Gjatë mbledhjeve të Senatit, anëtarët duhet të votojnë personalisht me prezencë fizike në mbledhje apo në rrugë elektronike (virtuale), nëse mbledhja mbahet në formë elektronike (virtuale). Delegimi i votës nuk lejohet.
- (3) Para se të fillojë mbledhja e Senatit, anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes, e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i Senatit mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje, anëtari i Senatit duhet ta njoftojë me kohë kryesuesin.
- (4) Nëse një anëtar i Senatit pa arsyetim të bazuar dhe pa njoftim paraprak sipas paragrafit 3 mungon tri herë radhazi në mbledhjet e Senatit, i njëjti *ex lege* humb statusin e anëtarit të Senatit.

Konflikti i interesit

Neni 8

- (1) Për një anëtar të Senatit konsiderohet se ka konflikt interesi, në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm dhe Statutin e Universitetit, nëse bie ndesh me interesin e tij publik, familjar dhe operacional.
- (2) Kryesuesi i Senatit është i obliguar që në fillim të çdo mbledhje t'i pyes dhe paralajmëroj anëtarët e Senatit për ekzistencën eventuale të konfliktit të interesit.
- (3) Anëtari i Senatit që është në konflikt interesi duhet të lëshojë mbledhjen gjatë asaj kohe kur diskutohet ajo çështje.
- (4) Anëtari në konflikt interesi nuk ka të drejtë vote për çështjen përkatëse.
- (5) Në rastet kur nuk ka qartësi të plotë për ekzistencën e konfliktit të interesit, atëherë kryesuesi i Senatit i drejtohet me kërkesë për konstatim organit kompetent brenda universitetit apo intucionit të specializuar shtetëror. Në këtë rast, vendosja lidhur me këtë pikë të rendit të ditës shtyhet deri në konstatimin përfundimtar të konfliktit të interesit nga ndonjëri prej organeve të lartëcekura.

Fillimi i mbledhjes dhe rendi i ditës

Neni 9

- (1) Kryesuesi e hap, kryeson, ndërpret dhe përfundon mbledhjen.
- (2) Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e Senatit kujdeset kryesuesi në koordinim me prorektorët dhe sekretarin e përgjithshëm me shërbimet përkatëse.
- (3) Kryesuesi është i obliguar që në rend të ditës t'i përfshijë propozimet e arsyetuara me shkrim, të dërguara 72 orë para mbledhjes. Propozimet me shkrim mund të dërgohen personalisht, me fax, me e-mail dhe të nënshkruara nga parashtruesi.
- (4) Në fillim të mbledhjes, kryesuesi konstaton se a ka kuorum, propozon rendin e ditës, hap diskutimin rreth rendit të ditës, konstaton miratimin e rendit të ditës.
- (5) Kryesuesi i jep fjalën diskutuesit, konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar, çështjen e vë në votim, konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit, ndërmerr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në mbledhje, konstaton përfundimin e mbledhjes dhe ndërmerr veprime tjera të nevojshme për udhëheqjen dhe drejtimin e mbledhjes konform me këtë Rregullorë.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

- (6) Anëtarët e Senatit kanë të drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, duke e arsyetuar propozimin.
- (7) Materialet ose kërkesat, të cilat bashkëngjiten gjatë mbledhjes mund të miratohen me shumicën absolute të votave.

Ecuria e mbledhjes
Neni 10

- (1) Pas miratimit të rendit të ditës, kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet që janë në kuadër të pikave të miratuara të rendit të ditës.
- (2) Raportin dhe arsyetimin për secilën pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar nga kryesuesi, pas të cilit kryesuesi e hap diskutimin.
- (3) Të gjithë anëtarët e pranishëm të Senatit mund të marrin pjesë në diskutim dhe t’i paraqesin mendimet dhe propozimet, lidhur me çështjet që do të vendosen në mbledhje.
- (4) Kryesuesi jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhjet e Senatit askush nuk mund të diskutojë pa e marr fjalën nga kryesuesi i mbledhjes.
- (5) Kryesuesi është përgjegjës për respektimin e Rregullores së punës, për veprimet dhe sjelljen e anëtarëve sipas radhës.
- (6) Për çdo pikë të rendit të ditës, pjesëmarrësit mund të diskutojnë më së shumti dy herë, herën e parë deri pesë minuta, të dytën deri dy minuta.
- (7) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë nga folësit që t’i përmbahen temës.
- (8) Pjesëmarrësi, i cili e merr fjalën, është i obliguar t’i përmbahet çështjes që është në shqyrtim. Çdo pjesëmarrës që konsideron se lidhur me fjalën e tij është shtrembëruar ndonjë fakt, me lejen e kryesuesit ka të drejtë të paraqitet për replikë menjëherë pasi të përfundojë diskutimin pjesëmarrësi, ndaj të cilit është paraqitur replika. Replika për të njëjtën çështje i lejohej pjesëmarrësit në diskutim vetëm dy herë dhe sipas rregullit, mund të zgjasë më së shumti dy minuta.
- (9) Kryesuesi ka të drejtë të ndërpresë mbledhjen më së shumti 30 minuta. Me pajtimin e Senatit kjo mund të zgjatet.
- (10) Kryesuesi është i obliguar të ndërpresë mbledhjen nëse ai vet nuk ka mundësi ta udhëheqë në mënyrë të drejtë.

Shtyrja e shqyrtimit për mbledhjen e radhës
Neni 11

Senati, në bazë të propozimit të kryesuesit ose të ndonjë anëtari të Senatit, mund të vendos që shqyrtimi për disa çështje specifike të ndërpritet dhe të përgatitet më hollësisht për mbledhjen e ardhshme.

Kërkesat dhe ankesat
Neni 12

- (1) Çdo anëtar i Senatit ka të drejtë të parashtrojë kërkesë – ankesë për temën e caktuar.
 - (2) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë që kërkesa – ankesa të parashtrohet me shkrim.
 - (3) Kërkesat – ankesat për rregullat procedurale duhet të arsyetohen shkurtimisht. Me kërkesë një folës “për” dhe një folës “kundër”, mund ta marrin fjalën.
- Kërkesat – ankesat për rregullat e procedurës mund të parashtrohen për dy arsye:



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

- a) kërkesa për mbylljen e listës së folësve të regjistruar, nëse kërkesa miratohet me shumicë të thjeshtë, vetëm folësit e regjistruar në listë gjatë parashtrësës së kërkesës do të kenë të drejtë ta marrin fjalën.
- b) Kërkesa për përfundimin e shqyrtimit, nëse kërkesa miratohet me shumicë të kualifikuar të 2/3 të anëtarëve, diskutimi mbaron dhe kërkesat tjera votohen.

Kourumi dhe votimi

Neni 13

- (1) Senati i Universitetit vendos plotëfuqishëm vetëm kur në mbledhje janë prezent së paku shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve, përveç nëse kërkohet kourum tjetër i paraparë me Statut për raste tjera të veçanta.
- (2) Para se të votohet, kryesuesi e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me atë pikë të rendit të ditës.
- (3) Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas pikës së rendit të ditës, Senati merr vendim ose konkluzion.
- (4) Vendimet, Senati i merr me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, përveç nëse Statuti përcakton ndryshe për ndonjë rast të veçantë.
- (5) Nëse ka më shumë propozime të vendimeve ose të konkluzioneve, së pari votohet për ato në material ose propozimet nga organet e Universitetit, pastaj për propozimet tjera.
- (6) Votimi bëhet i hapur ose me vota të fshehta. Se si do të bëhet votimi, Senati vendos në mbledhjen përkatëse.
- (7) Anëtarët e Senatit janë të obliguar të votojnë. Votimi bëhet: “për”, “kundër” dhe “abstenim”.
- (8) Në rast të numrit të votave të barabarta, propozimi konsiderohet i refuzuar.

Procedura e votimit të fshehtë

Neni 14

- (1) Procedurën e votimit të fshehtë e zbaton komisioni i emëruar nga Senati i përbërë prej tre anëtarëve.
- (2) Pas votimit, në bazë të rezultateve të votimit, kryesuesi, përkatësisht kryetari i komisionit, konstaton se propozimi i vendimit ose i konkluzionit është miratuar ose është refuzuar.

Votimi i fshehtë

Neni 15

- (1) Votimi me vota të fshehta bëhet për:
 - a) Zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues;
 - b) Për zgjedhjen e kryesuesit të përkohshëm të Senatit;
 - c) Çështjet që kanë lidhje me intimitetin e ndonjërit nga anëtarët e Senatit;
 - d) Çështjet kur kryesuesi kërkon për votim të fshehtë.
- (2) Numërimi i votave për këto çështje bëhet nën mbikëqyrjen e sekretarit të përgjithshëm.

Komisioni profesional për propozimin e listës për rektor

Neni 16

1. Përcaktimi i listës së kandidatëve për pozitën e rektorit bëhet nga Komisioni Profesional i zgjedhur nga Senati.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

2. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve të Senatit në pajtim me nenin 27 të Statutit. Komisioni ka për detyrë të konstatojë nëse kandidatët e paraqitur për rektor i plotësojnë kushtet e parapara me konkursin për rektor të shpallur nga Këshilli Drejtues i Universitetit.
3. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioni profesional propozon listën e kandidatëve të zgjedhur, me shumicë votash, për t'u zgjedhur nga Këshilli Drejtues.

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues

Neni 17

- (1) Senati zgjedh katër (4) anëtarë të Këshillit Drejtues me të drejtë vote nga personeli akademik i Universitetit.
- (2) Anëtarë të Këshillit Drejtues nuk mund të zgjedhen rektori, prorektori, dekani, prodekani dhe anëtarët e Senatit.
- (3) Çdo anëtar i Senatit ka të drejtë të bëjë propozime/nominime për kandidatët për anëtarë të Këshillit Drejtues të Universitetit.
- (4) Propozimet/nominimet për kandidatë duhet të jenë të arsyetuara mirë dhe të përfshijnë edhe një biografi të shkurtër për kandidatin.
- (5) Zgjedhja e kandidatëve bëhet me dy votime të njëpasnjëshme.
- (6) Propozimi/nominimi i kandidatëve për Këshill Drejtues në radhën e parë të votimit bëhet me shumicën relative të votave, me votim të hapur për secilin kandidat veç e veç. Vetëm kandidatët që arrijnë shumicën relative do të kalojnë në radhën e dytë të votimeve.
- (7) Në radhën e dytë, votimi do të bëhet për të gjithë kandidatët që kualifikohen në radhën e parë. Zgjedhja duhet të bëhet me vota të fshehta me fletëvotime sipas alfabetit. Secili anëtar i Senatit duhet të rumbullakësojë deri në katër (4) kandidatë në fletëvotim. Fletëvotimet me më shumë se katër (4) kandidatë konsiderohen të pavlefshme.
- (8) Kandidatët që marrin shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të votave të anëtarëve të Senatit konsiderohen të zgjedhur anëtar të Këshillit Drejtues. Nëse numri i kandidatëve që kanë fituar shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të votave është më i madh se katër (4) atëherë konsiderohen të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më së shumti vota.
- (9) Nëse në votimin nga paragrafi 8 i këtij neni nuk zgjedhen katër (4) anëtarët e Këshillit Drejtues, atëherë organizohet raundi tjetër i votimit. Në këtë votim kualifikohen vetëm kandidatët që kanë më së shumti vota. Numri i kandidatëve mund të jetë më së shumti sa dyfishi i vendeve të paplotësuara. Nëse në mesin e tyre ka edhe kandidatë me vota të barabarta, lista i përfshinë edhe të gjithë kandidatët me vota të barabarta. Në këtë votim, secili anëtar i Senatit duhet të rumbullakësojë më së shumti aq kandidatë sa janë vende të paplotësuara në Këshillin Drejtues. Edhe në këtë raund konsiderohen të zgjedhur kandidatët që kanë marrë shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të votave të anëtarëve të Senatit. Nëse numri i kandidatëve që kanë fituar shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të votave është më i madh se vendet e paplotësuara atëherë konsiderohen të zgjedhur kandidatët që kanë fituar më së shumti vota.
- (10) Nëse edhe në votimin nga paragrafi 9 i këtij neni nuk zgjedhen katër (4) anëtarët e Këshillit Drejtues, atëherë organizohet raundi tjetër i votimit. Në këtë votim kualifikohen vetëm kandidatët që kanë më së shumti vota. Numri i kandidatëve mund të jetë më së shumti sa dyfishi

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1



UNIVERSITETI - UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICË

i vendeve të paplotësuara. Nëse në mesin e tyre ka edhe kandidatë me vota të barabarta, lista i përfshinë të gjithë kandidatët me vota të barabarta. Në këtë votim, secili anëtar i Senatit duhet të rrumbullakësojë më së shumti aq kandidatë sa janë vende të paplotësuara në Këshillin Drejtues. Në këtë raund konsiderohen të zgjedhur ata kandidatë që kanë fituar më së shumti vota.

- (11) Në rast të numrit të barabartë të votave nga votimi sipas paragrafit 10 të këtij neni, një votim vendimtar do të bëhet vetëm për anëtarët me numër të barabartë votash. Në këtë votim konsiderohen të zgjedhur ata kandidatë që kanë fituar më së shumti vota. Nëse përsëri kandidatët marrin numrin e barabartë të votave përsëri do të votohet në procedurën e njëjtë deri në plotësimin e vendeve të paplotësuara të Këshillit Drejtues.

Zgjedhja e dekanëve dhe e prodekanëve

Neni 18

- (1) Vendimet propozuese mbi zgjedhjen e dekanëve të fakulteteve miratohen nga Senati i Universitetit.
- (2) Miratimi i propozimit bëhet në mbledhjen konstituive të Senatit, pas verifikimit të mandateve të anëtarëve të Senatit dhe pas zgjedhjes të kryesuesit të përkohshëm të Senatit.
- (3) Miratimi i propozimit të Fakultetit për zgjedhjen e dekanëve bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të përgjithshëm të Senatit me votim të hapur, për secilin veç e veç.
- (4) Nëse kandidati nuk merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe Këshilli i Fakultetit është i obliguar të propozojë kandidat tjetër.
- (5) Miratimi i propozimit të Fakultetit për zgjedhjen e prodekanëve bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të përgjithshëm të Senatit me votim të hapur, për secilin veç e veç.
- (6) Nëse kandidati nuk merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe Këshilli i Fakultetit është i obliguar të propozojë kandidat tjetër.
- (7) Përjashtimisht dhe në pamundësi që të zhvillohen procedurat e rregullta statutare dhe me qëllim të funksionimit të rregullt të njësive akademike, rektori apo Senati mundën që të emërojnë ushtrues detyre të dekanëve apo prodekanëve. Në këtë rast nuk zbatohen kushtet materiale dhe procedurale të Statutit. Ushtruesit e detyrës kryejnë detyrat e tyre vetëm deri në pushimin e arsyeve që kanë dërguar në caktimin e ushtruesve të detyrës apo deri në zhvillimin e zgjedhjeve në procedurë të rregullt statutare.

Mbajtja e rendit në mbledhje

Neni 19

- (1) Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset kryesuesi i mbledhjes.
- (2) Kryesuesi dhe pjesëmarrësit në mbledhjen e Senatit janë të obliguar që t'i përmbahen kësaj rregulloreje.
- (3) Për shkeljen e rendit në mbledhje mund të shqiptohen këto masa:
 - Vërejtje,
 - Marrja e fjalës dhe
 - Largimi nga mbledhja.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Shqiptimi i masave

Neni 20

- (1) Vërejtje me gojë mund t’i shqiptohet të pranishmit nëse me sjelljen dhe me diskutimin e tij çrregullon dhe pengon punën normale të mbledhjes.
- (2) Marrja e fjalës i shqiptohet anëtarit të Senatit, që me sjelljet dhe me deklaratat e tij çrregullon punën normale të Senatit për të cilën më parë i është shqiptuar vërejtje.
- (3) Vërejtjen dhe marrjen e fjalës i shqipton kryesuesi.
- (4) Largimi nga mbledhja i shqiptohet pjesëmarrësit nëse, edhe pasi t’i merret fjala, pengon mirëvajtjen e mbledhjes.
- (5) Largimin nga mbledhja e shqipton Senati me shumicë votash. Pjesëmarrësit, të cilit i është shqiptuar kjo masë, është i detyruar që menjëherë të largohet nga mbledhja. Largimi nga mbledhja bëhet vetëm për atë mbledhje. Senati, në të njëjten mbledhje, ruan të drejtën për dërgimin e rastit në Këshill të Etikës. Në këtë rast, Senati njëkohësisht mund të marrë një vendim paraprak me të cilin ndalon pjesëmarrjen e senatorit në mbledhjet e radhës së Senatit dhe atë deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Këshilli i Etikës.

Procesverbali nga mbledhja e Senatit

Neni 21

- (1) Në çdo mbledhje të Senatit mbahet procesverbal. Procesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi dhe procesmbajtësi.
- (2) Procesverbali duhet të përmbajë këto elemente:
 - a) vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes,
 - b) rendin e ditës,
 - c) listën e pjesëmarrësve dhe atyre që mungojnë,
 - d) të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse,
 - e) shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes.

Dokumentet shtesë duhet t’i bashkëngjiten procesverbalit.

- (3) Procesverbali duhet të përgatitet brenda një jave, pas mbledhjes së Senatit dhe si ekstrakt duhet t’u dërgohet anëtarëve të Senatit me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhshme të Senatit.
- (4) Procesverbali miratohet në mbledhjen e radhës të Senatit.
- (5) Procesverbali ruhet në arkiv të Universitetit, me materialet e shqyrtuara sipas pikave të rendit të ditës, si dokumente afatgjata.

Formimi dhe puna e komisioneve

Neni 22

- (1) Senati mund të formojë komisione të përhershme dhe të përkohshme në pajtim me nenin 50 të Statutit të Universitetit.
- (2) Komisionet janë organe ndihmëse të Senatit.
- (3) Komisionet e formuara nga Senati në pajtim me Statutin e Universitetit i ndihmojnë Senatit për çështje të veçanta të punës së tij.

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

**Aktet juridike të Senatit
Neni 23**

- (1) Senati nxjerr:
 - Rregullore;
 - Vendime;
 - Konkluzione;
 - Rekomandime.
- (2) Senati jep interpretim autentik të akteve që i miraton.
- (3) Procesmbajtësi është i obliguar të përgatisë vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet nga mbledhja e Senatit, ndërsa rregulloret i përgatit komisioni përkatës.

**Zbatimi i Rregullores
Neni 24**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje vlejné për të gjithë anëtarët e Senatit dhe për persona tjerë të ftuar ose të angazhuar në procedurat e Senatit.

**Zbatimi i Statutit dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë
Neni 25**

- (1) Për të gjitha çështjet, të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit të Universitetit dhe të Ligjit mbi Arsimin e Lartë.
- (2) Çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën e punës së Senatit dhe që nuk janë të rregulluara me ligj, Statut dhe këtë rregullore, mund të rregullohen me vendim të veçantë të Senatit.

**Zbatimi dhe interpretimi
Neni 26**

- (1) Për zbatimin e drejtë të kësaj Rregulloreje kujdeset kryesuesi i Senatit.
- (2) Interpretimin autentik të kësaj Rregulloreje e jep Senati.

**Ndryshimi dhe plotësimi
Neni 27**


Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje mund të bëhet sipas së njëjtës procedurë të miratimit.

**Shfuqizimi i rregullores paraprake
Neni 28**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen dispozitat e Rregullores mbi punën e Senatit nr. 602, të datës 04.06.2015.

**Hyrja në fuqi
Neni 29**

Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati i Universitetit.


Prof. dr. Alush Musaj
Kryesues i Senatit